



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 341 Prot.

Tiranë, më 11.02.2025

**URDHËR**

Nr. 15, datë 11.022025

**“PËR  
NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR MONITORIMIN E SJELLJES  
SË NËPUNËSVE CIVILË GJATË PROCESIT ZGJEDHOR”**

Në zbatim të nenit 204, të pikës 1, të gurmës “c”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 5 dhe 37 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

**K O N S T A T O J :**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 120 prot., datë 06.02.2025, “Mbi monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor”, ka udhëzuar njësinë përgjegjëse për të ngritur grupin e monitorimit, me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil dhe vijueshmërinë normale të punës së trupës së nëpunësve civilë, të pa ndikuar nga procesi zgjedhor gjatë veprimtarisë së tyre.

Në këto rrethana, mbështetur në bazën ligjore të sipërpërmendur,

**U R D H Ë R O J :**

1. Ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore me këtë përbërje:

- Znj. Alma Zili, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore - Kryetar.
  - Z. Nertil Kanina, Ndihmës Inspektor, Njësia e Ndihmës Inspektorëve - Anëtar.
  - Znj. Zonje Shelqizi, Specialist (Burime Njerëzore) në Sektorin e Burimeve Njerëzore - Anëtar.
2. Koordinatorin e grupit që do të komunikojë me palët e interesuara në këtë proces dhe me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil do të jetë znj. Alma Zili Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore.
  3. Grupi i punës të hartojë deri në datën **12.02.2025** rregulloren e brendshme të veprimtarisë së tij dhe të përcaktojë rregullime specifike për nëpunësit civilë gjatë periudhës zgjedhore, të cilën do ta paraqesë për miratim tek titullari i institucionit.
  4. Me këtë Urdhër dhe Rregulloren e Brendshme të grupit të punës të njihen të gjithë nëpunësit civilë dhe të informohet Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, brenda datës **14.02.2025**, duke i vënë në dispozicion një kopje të praktikës.
  5. Ngarkohen nëpunësit civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me zbatimin e këtij urdhri.
  6. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri, në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

**Artur Metani**